

Para	SKK 11 “TATIMI MBI FITIMIN” – PËRDITËSUAR (2023)
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 11 <i>Tatimi mbi fitimin</i> (SKK 11), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga ministri përgjegjës për financat, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të tatimit mbi fitimin si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin për kontabilitetin.
2	SKK 11 është i krahasueshëm me Seksionin 29 <i>Tatimi mbi të ardhurat</i> të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM-të (2015). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2015) është dhënë në paragrafin 40. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 11 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në Ligjin për kontabilitetin.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 64 deri 68 të SKK 1.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky Standard mbulon kontabilizimin e tatimit mbi fitimin. Ai i kërkon një njësie ekonomike të njohë pasojat tatimore aktuale dhe të ardhshme nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera të njohura në pasqyrat financiare. Njësitë ekonomike të vogla inkurajohen por nuk janë të detyruara të zbatojnë kërkesat e këtij standardi për tatimin e shtyrë.
5	Për qëllime të këtij Standardi, tatimi mbi fitimin përfshin të gjitha tatimet brenda dhe jashtë vendit mbi fitimet e tatueshme (të pagueshme nga shoqëria mëmë, njësitë e kontrolluara prej saj ose pjesëmarrjet). Tatimi mbi fitimin përfshin gjithashtu tatimin në burim, i cili paguhet nga një njësi e kontrolluar, pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët për shpërndarjet e bëra tek njësia ekonomike.
6	Ky Standard nuk trajton kontabilizimin e diferencave të përkohshme, që mund të krijohen nga grantet qeveritare ose nga përjashtimet tatimore të investimeve.
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
7	<p>Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesorë të përdorura në këtë Standard:</p> <p><u>Rezultati kontabël</u> është fitimi ose humbja e një periudhe kontabël, para zbritjes së tatimit mbi fitimin.</p> <p><u>Fitimi (humbja) i/e tatueshëm</u> është fitimi (humbja) kontabël i një periudhe, i/(e) përcaktuar në përputhje me rregullat e vendosura nga organet tatimore, mbi të cilin/(cilën) llogaritet tatimi mbi fitimin i pagueshëm (i zbritshëm).</p> <p><u>Shpenzimi (e ardhura) tatimor</u> është shuma totale që i zbritet (shtohet) fitimit (humbjes) kontabël për përcaktimin e fitimit ose humbjes neto të periudhës kontabël, dhe përbëhet nga shpenzimi (e ardhura) tatimor aktual dhe shpenzimi (e ardhura) tatimor i shtyrë.</p> <p><u>Tatimi aktual</u> është shuma e tatimit mbi fitimin, e pagueshme (e zbritshme) mbi fitimin (humbjen) e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale.</p> <p><u>Detyrime tatimore të shtyra</u> janë shumat e tatimit mbi fitimin, të pagueshme në periudha të ardhshme, të cilat krijohen për shkak të diferencave të përkohshme të tatueshme.</p> <p><u>Aktive tatimore të shtyra</u> janë shumat e tatimit mbi fitimin, të zbritshme në periudha të ardhshme, të cilat krijohen për shkak të diferencave të përkohshme të zbritshme.</p> <p><u>Tatimi i shtyrë</u> është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tatimi i pagueshëm (i zbritshëm) në periudhat e ardhshme, zakonisht si rezultat i realizimit të aktiveve ose shlyerjes së detyrimeve, nga njësia ekonomike, me vlerën e tyre aktuale kontabël; dhe - efekti tatimor i mbartjes së humbjeve tatimore dhe i tatimeve të zbritshme. <p><u>Diferencat e përkohshme</u> janë diferencat mes vlerës kontabël të një aktivi ose detyrimi në pasqyrën e pozicionit financiar dhe bazës së tij tatimore.</p> <p><u>Diferencat e përkohshme të tatueshme</u> janë diferenca të përkohshme që, në periudha të ardhshme kontabël, kur vlera kontabël e aktivitet ose detyrimit realizohet ose shlyhet, rezultojnë në shumën e tatueshme.</p>

	<p><u>Diferencat e përkohshme të zbritshme</u> janë diferenca të përkohshme që, në periudha të ardhshme kontabël, kur vlera kontabël e aktivitetit ose detyrimit realizohet ose shlyhet, rezultojnë në shumën të zbritshme tatimore.</p> <p><u>Baza tatimore e një aktivi ose detyrimi</u> është vlera e atij aktivi, ose detyrimi, e njohur dhe e pranuar për qëllime tatimore.</p>
	HAPAT PËR KONTABILIZIMIN E TATIMIT MBI FITIMIN
8	<p>Një njësi ekonomike duhet të kontabilizojë tatimin mbi fitimin duke ndjekur hapat (a)-(i) më poshtë:</p> <p>(1) njeh tatimin aktual, të matur në një vlerë që përfshin efektin e rezultateve të mundshme të një rishikimi nga autoritetet tatimore (paragrafët 9-12);</p> <p>(2) identifikon cilat aktive dhe detyrime mund të priten të ndikojnë në fitimin e tatueshëm nëse ato do të realizoheshin ose shlyheshin me vlerat e tyre kontabël aktuale (paragrafët 13 dhe 14);</p> <p>(3) përcakton bazën tatimore të elementeve të mëposhtëm në fund të periudhës raportuese të:</p> <p>(i) aktiveve dhe detyrimeve të identifikuara (sipas pikës 2); (<i>baza tatimore e aktiveve dhe detyrimeve përcaktohet nga pasojat e realizimit të aktiveve ose shlyerjes së detyrimeve me vlerat e tyre kontabël aktuale (paragrafët 14 dhe 15)</i>);</p> <p>(ii) zërave të tjerë që kanë një bazë tatimore megjithëse nuk janë njohur si aktive ose detyrime (p.sh., zërat e njohur si të ardhura ose shpenzime që do të bëhen të tatueshme ose të zbritshme për qëllime tatimore në periudhat e ardhshme (<i>paragrafi 16</i>)).</p> <p>(4) llogarit çdo diferencë të përkohshme, humbje tatimore të papërdorur dhe tatime të zbritshme (<i>paragrafët 17-18</i>).</p> <p>(5) mat aktivet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra në një vlerë që përfshin efektin e rezultateve të mundshme të një rishikimi nga autoritetet tatimore, duke përdorur norma tatimore që në fund të periudhës raportuese, janë të miratuara ose janë në thelb të miratuara dhe që në bazë të ligjeve tatimore priten të zbatohen kur aktivi tatimor i shtyrë realizohet ose kur detyrimi tatimor i shtyrë shlyhet (<i>paragrafët 22-24</i>).</p> <p>(6) njeh një provizion kundrejt aktiveve tatimore të shtyra në mënyrë që vlera neto e aktiveve tatimore të shtyra të barazojë vlerën më të lartë që ka më shumë mundësi të realizohet sesa jo, bazuar mbi fitimin e tatueshëm aktual ose të ardhshëm (<i>paragrafët 27 dhe 28</i>).</p> <p>(7) shpërndan tatimin aktual dhe të shtyrë tek elementet përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe të pasqyrës së ndryshimeve në kapital (<i>paragrafi 34</i>).</p> <p>(8) paraqet informacionin e kërkuar (<i>paragrafët 33-35</i>).</p>
	NJOHJA DHE MATJA E TATIMIT AKTUAL
9	Një njësi ekonomike njeh një detyrim tatimor të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm për periudhën aktuale. Nëse shumën e paguar për periudhën aktuale dhe periudhat e kaluara tejkalon vlerën e pagueshme për periudhën aktuale, njësi ekonomike njeh tejkalimin si një aktiv tatimor të zbritshëm (rimbursueshëm).
10	Një njësi ekonomike mat një detyrim (aktiv) tatimor aktual në vlerat që ajo pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit. Një njësi ekonomike duhet t'i konsiderojë normat tatimore si në thelb të miratuara atëherë kur ngjarje të ardhshme, pjesë e procesit të miratimit, historikisht nuk kanë ndikuar në rezultatin e këtij procesi dhe nuk ka mundësi të ndodhë një gjë e tillë. Paragrafët 2-31 japin udhëzime të mëtejshme në lidhje me matjen.
11	Një njësi ekonomike duhet të përfshijë, në vlerat e njohura në përputhje me paragrafin 9, efektin e rezultateve të mundshme të një rishikimi nga autoritetet tatimore, të matura në përputhje me paragrafin 31.
	NJOHJA E TATIMIT TË SHTYRË
	Parimi i përgjithshëm i njohjes
12	Një njësi ekonomike njeh një aktiv ose detyrim tatimor të shtyrë për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e njësisë ekonomike në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjen e këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm), të papërdorura.
	Aktivët dhe detyrimet realizimi ose shlyerja e të cilëve nuk do të ndikojë në fitimin e tatueshëm
13	Nëse njësi ekonomike pret të realizojë vlerën kontabël të një aktivi ose të shlyejë vlerën kontabël të një detyrimi pa ndikuar në fitimin e tatueshëm, atëherë nuk lind asnjë tatim i shtyrë përse i përket këtij aktivi ose detyrimi. Prandaj, paragrafët 14-21 zbatohen vetëm për aktivet dhe detyrimet për të cilat njësi ekonomike pret që realizimi ose shlyerja e vlerës kontabël të ndikojë në fitimin e tatueshëm, si dhe për zëra të tjerë që kanë një bazë tatimore.
	Baza tatimore

14	Një njësi ekonomike përcakton bazën tatimore të një aktivi, detyrimi ose ndonjë zëri tjetër, në përputhje me ligjin e miratuar ose që është në thelb i miratuar. Nëse njësi ekonomike paraqet një rezultat tatimor të konsoliduar, baza tatimore përcaktohet nga ligji tatimor që aplikohet mbi rezultatin tatimor të konsoliduar. Nëse njësi ekonomike paraqet rezultate tatimore të veçanta për aktivitete të ndryshme, baza tatimore përcaktohet nga ligjet tatimore që aplikohen mbi secilin rezultat tatimor.
15	Baza tatimore është vlera që do të përfshihet në fitimin e tatueshëm gjatë realizimit ose shlyerjes së vlerës kontabël të një aktivi ose detyrimi. Më konkretisht: (a) baza tatimore e një aktivi është vlera që do të jetë e zbritshme për qëllimin e llogaritjes së fitimit të tatueshëm, kur vlera kontabël e aktivitet realizohet përmes shitjes në fund të periudhës raportuese. Nëse realizimi i aktivitet përmes shitjes nuk e rrit fitimin e tatueshëm, atëherë baza tatimore e aktivitet supozohet që është e barabartë me vlerën kontabël të tij; (b) baza tatimore e një detyrimi është vlera e tij kontabël minus çdo vlerë të zbritshme për qëllimin e llogaritjes së fitimit të tatueshëm (ose plus çdo vlerë të përfshirë në fitimin e tatueshëm) që do të krijohej nëse detyrimi do të shlyhej me vlerën e tij kontabël në fund të periudhës raportuese. Në rastin e të ardhurave të shtyra, baza tatimore e detyrimit është vlera e tij kontabël, minus çdo shumë të ardhurash që nuk do të tatohet në periudhat e ardhshme.
16	Disa zëra kanë bazë tatimore, por ato nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si aktive ose detyrime. Për shembull, shpenzimet e punës kërkimore njihen si shpenzime në përcaktimin e fitimit kontabël në periudhën kontabël kur ato kanë ndodhur, por mund të mos lejohen si të zbritshme në përcaktimin e fitimit të tatueshëm (humbjes së tatueshme) të periudhës kur ato kanë ndodhur, pra të lejohen në periudha të ardhshme. Baza tatimore e shpenzimeve të punës kërkimore, është shuma që organet tatimore do ta pranojnë si të zbritshme në periudhat kontabël të ardhshme, ndërkohë që vlera kontabël në këtë rast është zero (në bazë të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SKK-të).
	Diferencat e përkohshme
17	Diferencat e përkohshme lindin në situata si p.sh: (a) kur, në njohjen e aktiveve ose detyrimeve, ka një diferencë mes vlerave kontabël dhe bazave tatimore të tyre, ose kur krijohet një bazë tatimore (për ato zëra që kanë një bazë tatimore) por nuk njihet asnjë aktiv apo detyrim; (b) kur, pas njohjes, lind një diferencë mes vlerës kontabël dhe bazës tatimore, për shkak se e ardhura ose shpenzimi njihet në kapital në një periudhë raportuese të caktuar, ndërkohë që në fitimin e tatueshëm njihet në një periudhë raportuese tjetër; (c) kur, baza tatimore e një aktivi ose detyrimi ndryshon dhe ndryshimi nuk ndikon në vlerën kontabël të aktivitet ose detyrimit, në asnjë periudhë raportuese.
18	Diferencat e përkohshme krijohen gjithashtu edhe kur: (a) kosto e një kombinimi biznesesh shpërndahet mbi bazën e vlerës së drejtë të aktiveve të identifikueshme të blera/përfuara dhe të detyrimeve të marra, ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon; Aktivitet ose detyrimi tatimor i shtyrë ndikon në shumën e emrit të mirë që një njësi ekonomike njeh. (b) aktivitet rivlerësohen ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon.
	Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra
19	Përveçse kur kërkohet nga paragrafi 22, një njësi ekonomike duhet të njohë: (a) një detyrim tatimor të shtyrë për të gjitha diferencat e përkohshme që priten të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen; (b) një aktivitet tatimor të shtyrë për të gjitha diferencat e përkohshme që priten të ulin fitimin e tatueshëm në të ardhmen; (c) një aktivitet tatimor të shtyrë për mbartjen e humbjeve tatimore ose tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.
20	Në vijim janë përjashtime nga kërkesat e paragrafit 20: (a) Një njësi ekonomike nuk duhet të njohë një aktivitet ose detyrim tatimor të shtyrë për diferenca të përkohshme të lidhura me fitimet e papaguara nga filialet e huaja, degët, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta në masën që investimi është, në thelb, i përhershëm në kohëzgjatje dhe njëkohësisht njësi ekonomike kontrolluese apo investitori ka kontrollin mbi përcaktimin e afatit të përfundimit të diferencës së përkohshme, përveçse kur është e dukshme që diferencat e përkohshme do të rimerren në të ardhmen e parashikueshme; (b) Një njësi ekonomike nuk duhet të njohë një detyrim tatimor të shtyrë për një diferencë të përkohshme të lidhur me njohjen e emrit të mirë.
21	Një njësi ekonomike duhet të njohë ndryshimet në një detyrim ose aktivitet tatimor të shtyrë, si shpenzim tatimor në humbje ose fitim, përveç atij ndryshimi që lidhet me një zë që është njohur në kapital sipas ndonjë SKK-je tjetër, i cili duhet gjithashtu të njihet në kapital.
	MATJA E TATIMIT TË SHTYRË
	Normat tatimore

22	Një njësi ekonomike duhet të masë një detyrim (aktiv) tatimor të shtyrë duke përdorur normat dhe ligjet tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara deri në datën e raportimit. Një njësi ekonomike duhet të marrë për bazë normat tatimore në thelb të miratuara atëherë kur ngjarjet e ardhshme, pjesë e procesit të miratimit, historikisht nuk kanë ndikuar në rezultatin e procesit dhe nuk ka mundësi të ndodhë një gjë e tillë.
23	Kur norma të ndryshme tatimore zbatohen për nivele të ndryshme të fitimit të tatueshëm, një njësi ekonomike duhet të masë shpenzimet (të ardhurat) tatimore të shtyra dhe aktivet / detyrimet tatimore të shtyra përkatëse duke përdorur normat mesatare të miratuara, ose në thelb të miratuara, që ajo pret të jenë të zbatueshme ndaj fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore) të periudhave në të cilat ajo pret që aktivi tatimor i shtyrë të realizohet ose detyrimi tatimor i shtyrë të shlyhet.
	Matja
24	Matja e detyrimeve tatimore të shtyra dhe aktiveve tatimore të shtyra duhet të reflektojë pasojat tatimore që burojnë nga mënyra në të cilën njësi ekonomike pret, në datën e raportimit, të realizojë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve përkatëse.
25	Një aktiv tatimor i shtyrë do të njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme deri në atë masë ku mendohet se do të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme.
26	Eliminimi i diferencave të përkohshme të zbritshme në periudhat e ardhshme shoqërohet me reduktime të fitimeve të tatueshme të këtyre periudhave. Megjithatë, reduktimet e fitimit të tatueshëm do të bëhen vetëm nëse njësi ekonomike ka fitime të mjaftueshme të tatueshme, kundrejt të cilave bëhet e mundur zbritja e diferencave të përkohshme.
27	Një njësi ekonomike duhet të njohë një provizion kundrejt aktivitetit tatimor të shtyrë, në mënyrë që vlera kontabël neto e tij të barazojë vlerën më të lartë që ka më shumë mundësi të realizohet sesa jo, bazuar në fitimin e tatueshëm aktual apo të ardhshëm.
28	Një njësi ekonomike duhet të rishikojë vlerën kontabël neto të një aktiviteti tatimor të shtyrë në çdo datë raportuese dhe duhet të rregullojë shumën e provizionit për të reflektuar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme të ardhshme. Rregullime të tilla duhet të njihen në fitim ose humbje, përveç rastit kur një rregullim ka lidhje me një zë që është njohur në kapital në përputhje me ndonjë SKK tjetër, i cili duhet gjithashtu të njihet në kapital.
	MATJA E TË DYJAVE: TATIMIT AKTUAL DHE TË SHTYRË
29	Aktivitetet dhe detyrimet tatimore, aktuale dhe të shtyra, nuk skontojnë.
30	Pasiguria për faktin nëse autoritetet tatimore do të pranojnë vlerat e raportuara nga njësi ekonomike, ndikon në vlerën e tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Një njësi ekonomike duhet të masë aktivitetet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe të shtyra duke përdorur vlerën mesatare të ponderuar mbi bazën e probabilitetit të të gjitha rezultateve të mundshme, duke supozuar që autoritetet tatimore do t'i rishikojnë vlerat e raportuara dhe kanë njohuri të plotë të informacionit përkatës. Ndryshimet në vlerën mesatare të ponderuar mbi bazën e probabilitetit të të gjitha rezultateve të mundshme duhet të bazohen mbi informacion të ri dhe jo në një interpretim të ri nga njësi ekonomike të informacionit të mëparshëm të disponueshëm.
31	Në disa juridiksione, tatimi mbi fitimin është i pagueshëm me një normë më të lartë ose më të ulët nëse një pjesë ose i gjithë fitimi i periudhës ose fitimi i pashpërndarë paguhet si dividend ndaj aksionarëve të njësisë ekonomike. Në të dyja këto rrethana, një njësi ekonomike duhet të masë tatimet aktuale dhe të shtyra me normën tatimore të zbatueshme ndaj fitimeve të pashpërndara, derisa njësi ekonomike njeh detyrimin për të paguar dividendin. Kur njësi ekonomike njeh detyrimin për të paguar dividendin, ajo duhet të njohë detyrimin (aktivin) tatimor aktual ose të shtyrë, si dhe shpenzimet (të ardhurat) tatimore të lidhura me to.
	MBAJTJA NË BURIM E TATIMIT MBI DIVIDENDËT
32	Kur një njësi ekonomike i paguan dividendë aksionarëve/ortakëve të saj, asaj mund t'i kërkohet të paguajë një pjesë të dividendëve si tatim mbi dividendin, ndaj autoriteteve tatimore në emër të aksionarëve (ortakëve). Një shumë e tillë e paguar ose e pagueshme ndaj autoriteteve tatimore i zbritet kapitalit, si pjesë e dividendëve.
	PARAQITJA NË PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR DHE NË PASQYRËN E PERFORMANCËS
33	Aktivitetet dhe detyrimet tatimore aktuale paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar, si pjesë e aktiveve afatshkurtra dhe detyrimeve afatshkurtra, ndërkohë që aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar, si pjesë e aktiveve afatgjata dhe detyrimeve afatgjata, duke përdorur zërat përkatës në formatin e pasqyrës së pozicionit financiar të dhënë në SKK 2 <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> .
34	Tatimet aktuale dhe të shtyra do të njihen si të ardhura ose shpenzime, si dhe do të përfshihen në fitimin ose humbjen e periudhës, përveç rasteve kur tatimi rrjedh nga një veprim ose ngjarje që njihet drejtpërdrejt në kapital, në të njëjtën periudhë kontabël ose në një periudhë të ndryshme.
	Kompensimi

35	Njësia ekonomike kompenson aktivet tatimore aktuale me detyrimet tatimore aktuale dhe aktivet tatimore të shtyra me detyrimet tatimore të shtyra, vetëm në rastet kur njësia: (a) ka një të drejtë ligjore për t'i kompensuar këto shuma; (b) synon të shlyejë (paguajë) shumën e tyre neto ose të realizojë aktivet, si dhe t'i shlyejë detyrimet në të njëjtën kohë.	
	SHËNIMET SHPJEGUESE	
36	Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që i jep mundësi përdoruesve të pasqyrave të saj financiare për të vlerësuar natyrën dhe efektin financiar të pasojave tatimore aktuale ose të shtyra të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera të njohura.	
37	Një njësi ekonomike duhet të deklarojë veçmas përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore. Përbërës të tillë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore mund të përfshijnë: (a) shpenzimet (të ardhurat) tatimore aktuale; (b) çdo rregullim i njohur në periudhën raportuese për tatimin aktual të periudhave të mëparshme; (c) shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme; (d) shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë që ka të bëjë me ndryshimet në normat tatimore ose aplikimin e tatimeve të reja; (e) efektin në shpenzimet tatimore të shtyra që lindin nga një ndryshim në rezultatet e mundshme të një rishikimi nga autoritetet tatimore (shiko paragrafin 30); (f) rregullimet në shpenzimet tatimore të shtyra që lindin nga një ndryshim në statusin tatimor të njësisë ekonomike ose aksionarëve/ortakëve të saj; (g) çdo ndryshim në shumën e provizionit (shiko paragrafët 27 dhe 28); (h) shumën e shpenzimit tatimor që ka të bëjë me ndryshimet në politikat dhe gabimet kontabël (shih SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i>).	
38	Një njësi ekonomike duhet të deklarojë veçmas si vijon: (a) së bashku, tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë, në lidhje me zërat që njihen si zëra të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; (b) shumat totale të tatimeve aktuale dhe të shtyra, që kanë të bëjnë me zërat e ngarkuar ose kredituar drejtpërdrejt në kapital; (c) një shpjegim të diferencave më kryesore midis vlerave të paraqitura në kapital dhe vlerave të raportuara tek autoritetet tatimore; (d) një shpjegim të ndryshimeve në normën(at) e zbatueshme tatimore krahasuar me periudhën paraardhëse raportuese; (e) për çdo lloj diference të përkohshme dhe për çdo lloj humbje tatimore ose tatimi të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur: (i) vlerën e detyrimeve tatimore të shtyra, aktiveve tatimore të shtyra dhe të provizionit në fund të periudhës raportuese; dhe (ii) një analizë të ndryshimit në detyrimet tatimore të shtyra, aktivet tatimore të shtyra dhe provizionit gjatë periudhës. (f) datën e skadimit, nëse ka, të diferencave të përkohshme, humbjeve tatimore dhe tatimeve të zbritshme (rimbursueshme) të papërdorura; (g) në rrethanat e përshkruara në paragrafin 31, një shpjegim të natyrës së pasojave të mundshme tatimore që mund të rezultojnë nga pagesa e dividendëve ndaj aksionerëve të njësisë.	
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
39	SKK 11 <i>Tatimi mbi fitimin</i> , përditësuar në vitin 2023, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2025. Kërkesat e SKK 11 (2023) do të zbatohen në perspektivë.	
	TABELA KRAHASUESE	
40	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM (2015). Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.	
	Paragrafët e SKK 10	
	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2015	
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 29.2
	Paragrafi 5	Sek 29.1
	Paragrafi 6	Sek 29.3
	Paragrafi 7	Sek 29.2, Sek 29.12

Paragrafi 8	Asnjë
Paragrafi 9	Sek 29.4
Paragrafi 10	Sek 29.6
Paragrafi 11	Asnjë
Paragrafi 12	Sek 29.8
Paragrafi 13	Sek 29.7
Paragrafi 14	Sek 29.12
Paragrafi 15	Sek 29.9, Sek 29.10
Paragrafi 16	Sek 29.11
Paragrafi 17	Sek 29.13 (d), Sek 29.15
Paragrafi 18	Sek 29.13 (a,b)
Paragrafi 19	Sek 29.7
Paragrafi 20	Sek 29.13 (c), Sek 29.14, Sek 29.25
Paragrafi 21	Asnjë
Paragrafi 22	Sek 29.27
Paragrafi 23	Sek 29.28
Paragrafi 24	Sek 29.29
Paragrafi 25	Sek 29.22, Sek 29.23, Sek 29.31
Paragrafi 26	
Paragrafi 27	
Paragrafi 28	
Paragrafi 29	Sek 29.32
Paragrafi 30	Asnjë
Paragrafi 31	Sek 29.33
Paragrafi 32	Sek 29.34
Paragrafi 33	Sek 29.36
Paragrafi 34	Sek 29.35
Paragrafi 35	Sek 29.37
Paragrafi 36	Sek 29.38
Paragrafi 37	Sek 29.39
Paragrafi 38	Sek 29.40
Paragrafi 39	Asnjë
Paragrafi 40	Asnjë